



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

Përfaqësuesi për Lirinë e Mediave

Analizë e Projektstrategjisë Shqiptare për Kalimin në Transmetimet Numerike

Profesor Katrin Nyman-Metcalf, ekspert i pavarur i OSBE-së

28 janar 2009

Përmbledhje

Ky raport bën një përmbledhje të projektstrategjisë shqiptare për kalimin në transmetimet numerike (nëntor 2008), duke paraqitur shkurtimisht faktet e pasqyruara në strategji, në raportet e përgatitura nga ekspertë ndërkombëtarë si dhe në dokumente të tjerë të ngjashëm. Më tej, raporti bën një analizë të projektstrategjisë duke komentuar mbi çështjet më të rëndësishme. Së fundi jepen një sërë sugjerimesh si për vetë strategjinë ashtu edhe për finalizimin e saj dhe çështje të tjera përkatëse.

Sugjerimet (në një variant të përmbledhur):

- Dixhitalizimi nuk zgjidh problemet e tjera në fushën e transmetimeve, siç janë mungesa e pluralizmit dhe larmisë apo një transmetues publik apo rregullator i dobët. Këto probleme duhen zgjidhur veçmas, përpara dixhitalizimit apo gjatë fazave të hershme.
- Është shumë e rëndësishme të ekzistojë një bazë e qartë ligjore për dixhitalizimin, duke përfshirë një ndarje të përmbajtjes dhe transmetimit teknik. Baza ligjore duhet të rregullojë situatën aktuale ashtu siç është dhe të merret me trajtimin e transmetuesit ekzistues dixhital.
- Strategjia duhet të hartohet me një proces konsultimi.
- Duhet të organizohet një fushatë për informimin e publikut.
- Standardet evropiane të cilave u referohet duhet të përdoren për interpretimin e koncepteve dhe nocioneve. Një gjë e tillë mund të bëhet e mundur me anë të një liste terminologjie.
- Financimi i procesit është thelbësor dhe duhet bërë i qartë në mënyrë transparente dhe të qëndrueshme në një fazë të hershme.

- Bashkëpunimi ndërinstitutional është shumë i rëndësishëm dhe ka nevojë për një kuadër të qartë.
- Aksesimi në facilitetet e transmetimit është qenësor dhe një kusht i rëndësishëm licencimi, ku rregullatorit i nevojitet një mandat i qartë për të parandaluar pasojat negative të monopolizimit.
- Transmetuesi publik duhet të forcohet dhe të mbështetet me detyrime të forta.
- Rregullat se kush ka të drejtën e dekoderave të subvencionuar dhe si përcaktohet kjo duhet të bëhen të qarta dhe të llogaritet kostoja e këtij procesi.

Hyrje

Dixhitalizimi ka mundësi të ofrojë më tepër mundësi për pluralizëm dhe larmi në fushën e transmetimeve pasi spektri ofron më shumë përdorues sesa me sistemin analog. Gjithsesi, sidomos në fazat fillestare, dixhitalizimi përmban rreziqe të tilla si monopolizimi dhe çimentimi i problemeve ekzistuese në fushën e transmetimeve. Vetë dixhitalizimi nuk do të zgjidhë problemet e mungesës së pluralizmit apo problemeve të tjera që krijohen për shkak të mungesës së lirisë së mediave apo për shkak të ndërhyrjes politike në fushën e medias.

Për të përfituar nga dixhitalizimi, është e rëndësishme të ekzistojë një proces planifikimi që përfshin të gjithë aktorët përkatës. Ambienti i transmetimeve dixhitale dhe procesi i dixhitalizimit duhet të kenë një bazë ligjore që të parashikojë masa mbrojtëse në interes të publikut, lirisë së shprehjes dhe aksesit në informacion. Ekzistojnë vetëm pak rregulla ndërkombëtare detyruese për procesin e dixhitalizimit (që lidhen më çështjet e frekuencave) por edhe nëse secili shtet i përcakton vetë hollësitë e procesit ka rregulla dhe standarde bazë që duhen ndjekur si dhe rekomandime ndërkombëtare mbi mënyrën se si mund të kryhet më mirë procesi i dixhitalizimit. Ndër fjalët më kyçe janë nxitja e larmisë dhe pluralizmit; shërbim efektiv i transmetuesit publik; akses universal dhe i përballueshëm në shërbimet e transmetimit dhe shërbimeve të tjera që ofron shoqëria e informacionit; kritere licencimi objektive, transparente, jodiskriminuese, dhe një proces licencimi i drejtë dhe transparent i administruar nga një organ i pavarur rregullator.

Ky raport analizon (projekt) strategjinë shqiptare (përkthimin jozyrtar të OSBE-së) për kalimin në transmetimet numerike që në nëntor të vitit 2008. Strategjia është hartuar nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT). Ky është një hap i mirë drejt procesit të dixhitalizimit, por është e rëndësishme që strategjia të përmirësohet dhe të bëhet pjesë e një procesi përfshirës e bashkëpunues, ku të përfshihen të gjitha palët përkatëse dhe të mbajë parasysh praktikën më të mirë ndërkombëtare si dhe realitetin shqiptar. Ky raport nuk merret me hollësi mbi çështjet teknike, përcaktimin e frekuencave apo çështje të tjera të lidhura me to.

Historik

Në maj të vitit 2004 u përgatit plani i parë i dixhitalizimit në Shqipëri. Ky plan u analizua nga Prezenca e OSBE-së së bashku me Zyrën Evropiane për Radiotelekomunikacionet (ERO) në shtator 2004. Një ndër çështjet që u theksua në atë analizë ishte se për dixhitalizimin duhej një planifikim i kujdesshëm dhe se nuk do ishte e përshtatshme të futej me nxitim transmetimi dixhital në një vend ku transmetimi analog nuk ishte normalizuar. Në analizën e përgatitur u shpreh frika se dixhitalizimi do të futej tepër herët, ndërkohë që mund të shihej mundësia e teknologjive të tjera të pranuar si p.sh. sistemi i shpërndarjes shumëkanalësh, shumëpikësh (MMDS), për televizionin me abonim, nëse ekzistonte vullneti për të siguruar televizionin me abonim.

Në analizën e OSBE/ERO-s u sugjerua që në vend të një ndryshimi të vullshëm, mund të bëheshin disa projekte pilote në disa pjesë të vendit (Tiranë). U propozua gjithashtu që të futeshin shërbimet e televizionit MMDS me abonim dhe dixhitalizimi të bëhej më vonë kur të ishte planifikuar në mënyrën e duhur.

Në maj të vitit 2007 Këshilli i Evropës porositi një studim mbi projektligjin shqiptar për transmetimet numerike nga një ekspert i pavarur (Znj. Eve Salomon) dhe Drejtorja e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Shoqërinë e Informacionit dhe Median. Qëllimi i projektligjit ishte krijimi i një kuadri për licencimin dhe rregullimin e transmetimeve dixhitale në Shqipëri, për televizionin tokësor dhe satelitor dhe transmetimet audio. Kuadri i licencimit mbulonte edhe rrjetet (multiplekset) edhe shërbimet e programeve individuale. Sipas ekspertëve ligji kishte pjesë të mira dhe ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare por ata rekomanduan gjithashtu një sërë ndryshimesh e shtesash, ku përfshiheshin përcaktimi i një kohe për kalimin dhe hartimin procesit të kalimit në transmetimet numerike për të siguruar një siguri financimi për transmetuesit dhe për të mënjeluar monopolizimin. Duhet ndërmarrë masa edhe për mbrojtur transmetimet lokale dhe rajonale. U propozua edhe mbështetje për transmetuesin publik në peisazhin e transmetimeve numerike. U theksua rëndësia e udhëzuesve elektronikë të programeve, standardet e hapura, ndëroperabiliteti si dhe përshtatshmëria e vazhduar e standardeve evropiane si ato të reflektuara në Konventën e Televizionit pa Kufi.

OSBE-ja e ka mbështetur me mënyra të ndryshme KKRT-në gjatë vitit 2008 me planifikimin e dixhitalizimit ku përfshihet edhe përgatitja e një strategjie dixhitalizimi. Ndihma e OSBE-së nuk ka konsistuar vetëm në mbështetjen e punës konkrete për strategjinë por edhe në mbështetjen e procesit, për të siguruar që procesi të jetë përfshirës me pjesëmarrjen e të gjitha

palëve të interesuara. Një proces i tillë përfshirës planifikimi mund të shërbejë si model politikëbërjeje edhe për fusha të tjera. Në planifikimin e strategjisë së dixhitalizimit, KKRT-ja pati asistencën e një eksperti nga organi rregullator francez i transmetimeve e cila përshinte rekomandime mbi përfshirjen e sektorit në proces. Asistenca e dhënë nga OSBE-ja ndihmoi të përcaktohej se në procesin e dixhitalizimit mungonte ndërgjegjësimi dhe bashkërendimi. Pati gjithashtu probleme me nivelin e njohjes së terminologjisë dhe çështjeve të tjera nga shumë partnerë.

Instrumentet ligjorë ndërkombëtarë

Parimet e vendosura në instrumentet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë e dixhitalizimit, parimit të neutralitetit teknologjik dhe respektit për audiencën dhe konsumatorët. Nuk është e nevojshme të ekzistojë një legjislacion i veçantë për dixhitalizimin. Disa vende e kanë një legjislacion të tillë por praktika më e njohur është amendimi i ligjeve përkatëse të fushës, si për shembull ligji për komunikacionet apo ligji për transmetimet dhe/apo telekomunikacionin. Çështja e ekzistencës së një ligji të veçantë apo se cili legjislacion duhet të amendohet, ndryshon nga vendi në vend në varësi të sistemit ligjor. E rëndësishme është që të ekzistojë baza e duhur ligjore për dixhitalizimin pasi ai përshin një sërë çështjesh për të cilat siguria dhe saktësia ligjore është thelbësore.

Planifikimi i frekuencave nga rregullatori duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duhet të sigurojë përdorimin sa më të mirë të frekuencave në dispozicion për platformat e ndryshme në mënyrë që të ketë pluralizëm dhe një garanci që transmetuesi publik të arrijë (pothuajse) të gjithë popullsinë. Planifikimi i Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (UNT) për dixhitalizimin është i rëndësishëm për të gjitha vendet pasi UNT-ja është përgjegjës për spektrin e frekuencave. Megjithëse shtetet mund të vendosin vetë kur dhe si ta kryejnë dixhitalizimin, planifikimi i UNT-së për mbylljen e analogut në Evropë dhe në disa rajone të tjera në 2015, është e detyrueshme për anëtarët e UNT-së (që janë praktikisht të gjitha shtetet e botës). Rregullimi i frekuencave nga UNT-ja është detyrues dhe shtetet anëtare duhet të sigurohen që procedurat e tyre të jenë në përputhje me këto rregulla ndërkombëtare dhe të jenë në gjendje t'i përmbushin ato.

Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nënvizon rëndësinë e lirisë së shprehjes por parashikon gjithashtu se rregullimi i transmetimeve nuk përbën shkelje të kësaj lirie. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut thekson se mënyra e zbatimit të kritereve të

licencimit në procesin e licencimit duhet të sigurojë garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, duke përfshirë edhe arsyetimin e duhur nga ana e autoritetit licencues për vendimet që refuzojnë licencat e transmetimit.¹

Rekomandimi (2003)9 i Këshillit të Evropës thekson nevojën për një strategji të mirëpërcaktuar dixhitalizimi dhe kushtet e përshtatshme ligjore dhe ekonomike për procesin. Në po këtë rekomandim thuhet se procesi duhet bërë në këshillim me industrinë e ndryshme të përfshira dhe me publikun. Kriteret për dhënien dhe rinovimin e licencave të transmetimit duhet të përcaktohet qartë në ligj. Ato duhet të zbatohen në mënyrë të hapur, transparente dhe të paanshme. Vendimet duhet të argumentohen, të jenë të hapura për rishikim dhe të disponueshme për publikun.

Ka edhe rekomandime të tjera të rëndësishme të Këshillit të Evropës në fushën e transmetimeve dixhitale. Një rekomandim i tillë është Rekomandimi (2000)23 për pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregullatore në fushën e transmetimeve, në të cilin thuhet se kushtet dhe kriteret bazë për dhënien dhe rinovimin e licencave për transmetim duhet të përcaktohen qartë në ligj. Rregulloret për procedurën e licencimit të transmetimeve duhet të jenë të qarta e të sakta dhe të zbatohen në mënyrë të hapur, transparente dhe të paanshme. Vendimet e marra nga autoritetet rregullatore duhet të bëhen publike.

Rekomandimi (1999)1 për pluralizmin e medias ka një rëndësi të veçantë në ambientin e dixhitalizimit për shkak të rrezikut të përqendrimit sidomos në fazat e para të dixhitalizimit. Rezoluta 1636 (2008) e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës e përcakton transparencën e pronësisë së medias dhe influencën ekonomike mbi median, si një nga treguesit e medias në një shoqëri demokratike.

Akresi universal i transmetimeve është një parim i rëndësishëm në fushën dixhitale. Rregullat detyruese mbeten thelbësore dhe nënkuptojnë se në një mjedis dixhital transmetuesi publik duhet të përfshihet në paketat e ofruara nga ofruesit. Duke qenë se rregulla të tilla nënkuptojnë një farë shkelje të sipërmarrjeve private për të bërë biznes, është e rëndësishme që rregullat të jenë proporcionale dhe të rishikohen rregullisht në mënyrë që të jenë gjithmonë në përputhje me të mirën e publikut dhe të mos jenë më ndërhyrëse sesa duhet.

¹ Ndër disa raste mund të përmenden *Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov kundër Bullgarisë*, nr. 14134/02 dhe *Meltex Ltd dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë*, nr. 32283/04.

Nuk ekziston një ligj i BE-së për hollësitë e dixhitalizimit.² Ekzistojnë direktiva si pjesë e kuadrit të telekomunikacionit si dhe rekomandime për kalimin dixhital, p.sh. në Komunikatën e Komisionit COM (2005) 204. BE-ja thekson parimin e neutralitetit teknologjik, duke deklaruar se ndihma e shtetit që i jepet vetëm televizionit dixhital tokësor është kundër parimeve të BE-së për ndihmën shtetërore, pasi ajo bën dallime në favor të një teknologjie. Menaxhimi i spektrit të radios duhet të bazohet në kritere objektive, transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale. Ky parim rrjedh nga neni 9 i Direktivës 2002/21/EC. Këto parime duhet të zbatohen për përzgjedhjen e përdoruesve të frekuencave, por edhe për të mbështetur pozicionin neutral të teknologjisë. Aksesit hapur i dekodereve është i rëndësishëm dhe instrumentet ndërkombëtare theksojnë rëndësinë e ndëroperabilitetit (Rekomandimi 2003(9), Direktivat 95/47/EC dhe 2002/22/EC e të tjera). Direktiva për Shërbimet e Medias Audiovizuale 2007/65/EC, është gjithashtu e përshtatshme (kjo direktivë është ende në periudhën e zbatimit).

Shqipëria ka një Marrëveshje Stabilizim-Asociimi me Bashkimin Evropian që nga viti 2006 në të cilën parashikohet bashkëpunimi në fushën audiovizuale. Gjithsesi kjo nuk parashikon që Shqipëria ka detyrimin e respektimit të afateve të BE-së për dixhitalizimin.

Organet ndërkombëtare që kanë analizuar përpjekjet për dixhitalizim në vende të ndryshme, kanë theksuar nevojën për konsultime (për shembull Instituti për një Shoqëri të Hapur (OSI), Neni XIX dhe të tjerë). Një proces i suksesshëm dixhitalizimi kërkon përfshirjen e organeve të ndryshme shtetërore si dhe të grupeve të tjera. Mbrojtja e konsumatorëve, pluralizmi i mediave dhe konkurrenca janë çështje që duhet të merren parasysh siç vërehen edhe nga the OSI (dhe Neni XIX).

Situata e mediave në Shqipëri

Në peisazhin audiovizual të mediave në Shqipëri përfshihen shumë aktorë, me një numër të madh transmetuesish (sidomos televiziv) pavarësisht se është një vend i vogël. Ka një transmetues publik (radio dhe televizion). Ka edhe 3 stacione televizive kombëtare dhe 73 stacione televizive lokale. Mundësitë e kufizuara monitoruese të KKRT-së nuk lejojnë të dhëna ekzistuese mbi veprimtaritë e tyre aktuale. Ky fakt dhe struktura gjeografike e vendit

² Kjo për arsye se një çështje e tillë është kompetencë e vendeve anëtare të BE-së në bazë të ndarjes së kompetencave që rrjedhin nga traktatet e KE-së dhe BE-së.

krijojnë një pamje mjaft komplekse transmetimesh. Në kontekstin evropian, Shqipëria ka një penetrim të ulët interneti dhe kompiuterash, megjithëse në këtë fushë po vërehet një ndryshim i vrullshëm. Në vitin 2007, penetrimi i internetit ishte rreth 15%.

Në Shqipëri ka një rregullator të pavarur të transmetimeve, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT). Ky rregullator është gjithashtu edhe organi përgjegjës për procesin e dixhitalizimit.

Legjislacioni shqiptar për transmetimet përbëhet nga ligji për televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë (ligji nr. 8410 i vitit 1998), i ndryshuar. Përveç këtij ligji ekziston edhe një ligj i veçantë për dixhitalizimin (Ligji nr. 9742, datë 28 maj 2007). Ky ligj duhet të integrohet në ligjin shqiptar për radiotelevizionin. Në strategji thuhet se ligji për dixhitalizimin ka mangësi, siç është mungesa e dallimit midis ofruesve të programeve dhe transmetuesve dhe mundësia e rrezikut të monopolizimit në duart e vetëm pak ofruesve të fuqishëm programesh. Ligji nuk mban parasysh faktin e kryer të krijuar nga ekzistenca e transmetuesit dixhital, DIGITALB.

Është në proces hartimi i një ligji të ri për transmetimet me anë të të cilit do të rregullohet edhe dixhitalizimi. Kjo nismë është ndërmarrë në kuadër të një plani veprimi të rënë dakord nga Kuvendi i Shqipërisë, Delegacioni i KE-së dhe KE-ja. Sidoqoftë ky proces nuk ka përfunduar ende dhe në strategji nuk përcaktohet ndonjë datë apo afat për përfundimin e tij.

Një tipar i veçantë i peisazhit dixhital shqiptar është fakti se televizioni dixhital ekziston që në vitin 2004. DIGITALB-i ofron television dixhital (katër rrjete fikse dhe një të lëvizshëm) për pothuaj të gjithë vendin. Ky televizion është zhvilluar pa asnjë ligj apo strategji mbi dixhitalizimin. DIGITALB-i ofron kanale falas dhe me pagesë si dhe prodhon disa programe. Nuk dihet numri i saktë i abonentëve, por mendohet të jetë mjaft i lartë. Për marrjen e transmetimit duhet një pajisje e veçantë. DIGITALB-i është edhe ofrues programi edhe transmetues dixhital, si dhe drejton veprimtarinë tregtare të transmetimit – pra i përmbledh në një subjekt funksionet që në shumë ambiente transmetimesh dixhitale ndahen në dy ose tre subjekte të veçantë. Për më tepër, DIGITALB-i transmeton gjithashtu edhe televizion të lëvizshëm në një frekuencë të paautorizuar. DIGITALB-i dhe veprimtaritë e tij janë pjesë e realitetit të transmetimeve në Shqipëri dhe pavarësisht faktit se kompania nuk ka bazën e duhur ligjore apo të licencimit për operacionet e veta, ajo duhet të përbëjë një faktor kontribues në çfarëdolloj zhvillimi të procesit të dixhitalizimit. Situata ku transmetuesit dixhitalë kanë marrë frekuenca analoge duhet marrë në konsideratë në planifikim pasi kjo do

të thotë që pikënisja nuk është në përputhje me licencat e lëshuara. Ka gjithashtu edhe dy programe të tjerë të cilët ofrojnë transmetime dixhitale eksperimentale në rrethin e Tiranës, "Super Sport" prodhuar nga "Klan TV" dhe "Tring" prodhuar nga Vizion +. Në tetor të vitit 2008, KKRT-ja hapi tre tendera për operatorë rrjeti dixhitalë (afati fillestar për aplikuesit ishte nëntori, më pas u shty deri më 6 janar 2009) pa një ligj të zbatueshëm për dixhitalizimin apo një strategji dixhitalizimi. Data e zëvendësimit të plotë të transmetimeve analoge me ato dixhitale është vendosur të jetë data 31 dhjetor 2012. Ky afat është shtyrë dy herë, e megjithatë në fund të procesit nuk u dorëzua asnjë kërkesë. Arsyeja e këtij abstenimi mbetet e paqartë.

KKRT-ja është vënë nën presion për të hartuar sa më shpejt një plan dixhitalizimi. Një plan i tillë nuk mund të transferohet nga një vend në tjetrin, edhe nëse disa elementë janë të njëjtët dhe përvoja e vendeve të tjera është e dobishme. Është thelbësore që plani jo vetëm të jetë i përshtatshëm për vendin për të cilin hartohet por të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë palët e interesuara. Presioni mbi KKRT-në për të hartuar një plan shpejt e shpejt çoi në bashkëpunimin me OSBE-në, gjë që bëri të mundur raundin e parë të konsultimeve me mediat në pranverë të vitit 2008. Për shkak të këtij presioni kohor, KKRT-ja e përfundoi draftin në verë-vjeshtë të 2008 pa konsultime të mëtejshme (dhe pa konsultimin e OSBE-së) dhe vazhdoi përpara më një proces të përshpejtuar. Pas disa problemeve me bashkëpunimin dhe pas kritikave nga komuniteti i mediave në Shqipëri, u bë e mundur të rifilloin konsultimet në dhjetor 2008 si dhe rifilloi bashkëpunimi me OSBE-në. Sidoqoftë mbetet presioni politik për një proces të përshpejtuar.

Strategjia e dixhitalizimit

Qasja

Një nga rekomandimet e Këshillit të Evropës dhe OSBE-së është nevoja për një planifikim të kujdesshëm të dixhitalizimit dhe një proces që të përfshijë palët e ndryshme të interesuara. Duhet të ketë konsultime, mundësi që palët e interesuara të dërgojnë komente (duke përdorur internetin) dhe në përgjithësi një metodë pune që të sigurojë sa më shumë të jetë e mundur një produkt përfundimtar që të jetë rezultat i një procesi të pranuar nga sektori.

Territori dhe popullsia

Në planin e dixhitalizimit është e rëndësishme të merret parasysh më shumë mbulimi i popullsisë sesa i territorit. Përpara mbylljes së transmetimeve analoge, duhet të ketë një mbulim të popullsisë pothuajse 100% kështu që njerëzit të mos privohen nga transmetimet, duke vështirësuar kështu aksesin në informacion. Një pjesë e rëndësishme e planifikimit është një fushatë informimi për të rritur interesin e popullsisë për procesin. Strategjia përfshin një përshkrim të detajuar të situatës së transmetimeve në Shqipëri duke përfshirë edhe televizionin tokësor dixhital, tashmë operues të DIGITALB.

Procesi

Strategjia hapet duke theksuar nevojën për një proces gjithëpërfshirës, duke përfshirë në strategji përdoruesit e shërbimeve audiovizuale, industrinë, operatorët e rrjeteve dhe ata që ofrojnë përmbajtje. Është e rëndësishme që ky pohim të ndiqet gjithashtu në realitet përmes hartimit dhe zbatimit të strategjisë. Nën seksionin 1.3 përshkruhet procesi i konsultimit publik. Theksohet se një proces i suksesshëm dixhitalizimi kërkon konsultime dhe bashkëpunim. Mes partnerëve që duhen përfshirë në operacion përmenden një gamë e gjerë partnerësh si shteti, strukturat ligjberëse dhe ekzekutive, organizatat joqeveritare në fushën e medias, operatorët, qytetarët dhe konsumatorët. Është me rëndësi që të gjenden mjetet për t'i dhënë efekt real këtyre pohimeve të bashkëpunimit.

Strategjia i referohet procesit të konsultimit të zhvilluar me OSBE-në dhe pohon se pikëpamjet e përcjella janë marrë parasysh. Nuk është e qartë se ku qëndron procesi i konsultimit në formën aktuale të strategjisë. Këto dokumente duhen përcjellë për konsultim dhe partnerët duhet të kenë në dispozicion mjete për të komentuar mbi këtë version (thujtje) final. Është me rëndësi të dëgjohet dhe mendimi i partnerëve rreth çështjes nëse këndvështrimi i tyre është marrë parasysh apo jo, dhe jo vetëm mendimi i agjencisë. Vetëm kështu do të ishte një proces i mirëfilltë gjithëpërfshirës. Konsultativi nuk mund të përfundojë me adoptimin e strategjisë së re por duhet të vazhdojë, sidomos duke qenë se kjo strategji në shumë çështje nuk është shumë e qartë. Është pozitive që dokumenti pohon qartë se procesi i konsultimit do të vazhdojë.

Konteksti ndërkombëtar

Pohimet në hyrjet e strategjisë mbi nevojën për dixhitalizim dhe mbi atë që e shtyn përpara këtë proces janë të sakta por afati i BE-së nuk është detyrues për Shqipërinë. Ka një referencë për standardet dhe praktikatat evropiane. Edhe më poshtë në dokument deklarohet që sfondi i

propozimeve janë praktikat më të mira ndërkombëtare, rekomandimet e BE-së, debatet si dhe realiteti shqiptar.³ Në dokument ka një përzierje ligjesh dhe rekomandimesh detyruese të BE-së. Kjo është më pak e rëndësishme për një shtet joanëtar pasi të gjitha këto instrumente mund të shihen si rekomandime orientuese. Për shtetet anëtare të BE-së (ose shtetet në pritje të anëtarësimit) kuptimi i natyrës së ndryshme të dokumenteve të ndryshme të BE-së është më i rëndësishëm. Rëndësia e referimit të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare qëndron në rast se diskutohen mënyrat për përkufizimin dhe interpretimin e koncepteve dhe termave, duhen përdorur interpretimet ndërkombëtare të pranuar. Me përmendjen e dokumenteve specifike roli i ndihmesës për interpretim është edhe më i qartë. Supozohet se përmbajtja e këtyre dokumenteve, aty ku është me rëndësi, duhet parë për t'u përfshirë në strategjinë shqiptare. Strategjia i referohet Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimit dhe afatit të tij detyrues për dixhitalizimin e spektrit të frekuencave. Ky është një shembull i një rregulloreje ndërkombëtare detyruese, shih sa më lart.

Dokument i referohet MSA-së me BE-në. Përfundimi se dixhitalizimi duhet të jetë në pajtim më ketë është i saktë por nuk jep ndonjë rregull të caktuar mbi detajet e këtij procesi, pasi nuk ka një ligj të BE-së për hollësitë e dixhitalizimit. Direktivat e përmendura (paketa e ashtuquajtur e Telekomunikimit) përfshijnë elementët bazë të dixhitalizimit si rregullimi neutral i teknologjisë (Direktiva 2002/21/EC, Direktiva Kornizë).⁴ Këta elementë duhen përfshirë në strategjinë shqiptare. Megjithëkëtë, kjo ende lë hapësira për zgjedhje shqiptare sa i përket afateve, brenda objektivit të UNT-së.

Qëllimet dhe objektivat e strategjisë

Dokumenti përcakton se si synimi i tij është t'i paraprijë objektivave dhe parimeve kryesore të kalimit në dixhital, të përcaktojë rolin e shtetit dhe të strukturave përkatëse të administratës shtetërore për krijimin e kushteve të nevojshme për kalimin në dixhital, të ofrojë një vlerësim të gjendjes aktuale teknike dhe ligjore të peizazhit audiovizual shqiptar dhe të përcaktojë hapat, procedurat dhe afatet për përmbushjen e procesit të kalimit brenda vitit 2012.

³ Shih për shembull "Hapja e fjalës në Internet" ("Spreading the Word on the Internet", Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, 2003, ku citohen statistikat e UNT-së e Medias, 2003, ku citohen statistikat e UNT-së të viti 2003, sipas të cilave penetrimi i kompjuterit në Shqipëri ka qenë 0,76%, më i ulëti në Evropë.

⁴ Përmendet Direktiva 2007/11/12 e KE-së. Nuk ekziston asnjë Direktivë ose legjislacion tjetër i BE-së me këtë numër dhe direktivat me numrat 11 dhe 12 për 2007 trajtojnë çështje të tjera. Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizuale është 2007/65/EC.

Dixhitalizimi do të luajë një rol në shoqërinë e informacionit; shërbimet e ofruara publikut do të rriten.

Strategjia përmend se ligji për dixhitalizimin nuk duket i përshtatshëm për të garantuar një kalim të suksesshëm në Shqipëri. Ligji në fjalë përcakton parimin e dhënies së licencës për multiplekset në bazë të procedurave të konkurrencës për operatorët e rrjetit, por nuk bën dallim të mjaftueshëm mes operatorëve të rrjetit dhe operatorëve të programit. Nuk merr parasysh që çmimi i ofruar për licencën e multipleksit mund të çojë në përqendrim dhe nuk merr parasysh statusin ekzistues të DIGITALB-it.

Sa i përket futjes reale të dixhitalizimit prezantohen ide të ndryshme si dixhitalizimi i butë, duke përdorur frekuencat që janë të disponueshme ose ideja e ishujve dixhitalë. Përgjithësisht është ide e mirë të fillohet me projekte pilot dhe të zhvillohet gradualisht. Gjithsesi, në Shqipëri tashmë dixhitalizimi ka hyrë në masë (me frekuenca të menduara për analog) ndaj koha për eksperimente individuale në praktikë mund të ketë kaluar. Cilado metodë që të zgjidhjet, koha për prezantim është e kufizuar.

Strategjia përmend se ka disa ide fillestare për sigurimin e financimit për ndërtimin e rrjeteve dixhitale për operatorin publik, përfshirë financimin e përzier me entet private. Strategjia thotë se hartimi i një propozimi të saktë për financimin e ndërtimit të rrjeteve dixhitale do të vendoset pas konsultimit me institucione të tjera kompetente shtetërore, që më pas do të ndiqet nga faza të hollësishme zbatimi sipas fondeve përkatëse. Kjo nuk specifikohet në strategji dhe duket se idetë janë në një fazë të hershme kur në fakt duhet të jenë sfondi i dixhitalizimit.

Objektivat dhe parimet e strategjisë përcaktohen: *Qëllimi politik i këtij Dokumenti strategjik është përpjekja për të përdorur teknologjinë e avancuar për rritjen e përgjithshme të standardit të jetesës, arsimimit, mbështetjen për krijimin e një shoqërie të informacionit, zhvillimin e tregut të mediave elektronike nëpërmjet rritjes së atraktivitetit të programeve të ofruara, përmes përmirësimit të cilësisë dhe pluralitetit të transmetimit, krijimit të hapësirës së nevojshme për hyrjen e kompanive të reja në treg dhe për zhvillimin e shërbimeve të reja. Gjithashtu, për të mbështetur përhapjen dhe zbatimin e faciliteteve të reja teknologjike që lidhen me transmetimet numerike, të tilla si televizioni high-definition (HDTV), televizioni i projektuar për “mobile reception” (DVB-H) etj.*

Strategjia parashtron një numër objektivash me pika:

1. Kalimi i transmetimeve ekzistuese analoge në platforma numerike brenda 2012

2. Legalizimi dhe vendosja e veprimit të ligjit mbi operatorët ekzistues të rrjeteve numerike të ngritur pa licencë.
3. Ofrimi i një shumëllojshmërie programesh, në sajë të rritjes së kapaciteteve, që do të rrisë mundësinë e zgjedhjes nga publiku.
4. Rritja e cilësisë dhe futja e shërbimeve të reja (HD, shërbimet interaktive)
5. Aplikimi i mekanizmave të tregut nëpërmjet rregullimit të aksesit dhe interkoneksionit në rrjetet transmetuese.
6. Aplikimi i standardeve më të përparuara që do të mundësojnë konvergjencën e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikacioneve elektronike.
7. Shërbimi Universal që do të ofrojë shërbime me cilësi të përcaktuar dhe me çmim të arsyeshëm pavarësisht nga shtrirja gjeografike.

Transmetimi dixhital dhe analog njëkohësisht është i kushtueshëm dhe strategjia këshillon kundër kësaj, që është gjë e mirë.

Qëllimet dhe objektivat janë për t'u përgëzuar por strategjia është më shumë një përshkrim i situatës aktuale dhe një hap i parë se sa mjet për t'i arritur këto objektiva. Efektet pozitive të dixhitalizimit për konsumatorët, ofruesit dhe shtetin siç paraqiten janë të sakta, por në shumë vende plani është i paqartë se si do të arrihen këto objektiva. Kjo vlen veçanërisht për konvergjencën dhe përdorimin e shërbimeve të tjera. Përmenden shkurtimisht parime të rëndësishme të licencimit, si ndarja e licencimit të përmbajtjes nga ai i transmetimit.

Pajisjet

Plani thotë se kalimi në dixhital duhet të garantojë përputhshmërinë e pajisjeve që *aktualisht zotërohen nga publiku me pajisjet e reja*, si dhe përputhshmërinë e siguruesve të ndryshëm. Objektivi i përgjithshëm është që kalimi në dixhital të sigurojë një opsion të aplikueshëm për shumicën e popullsisë. Kuptimi i kësaj është disi i paqartë pasi dihet se nevojiten pajisje shtesë (aparate) për marrjen e dixhitalit tokësor. Nevoja e njerëzve për të marrë këto pajisje shtesë është në fakt një nga problemet e dixhitalizimit pasi ekziston rreziku që shtresat më të varfra të shoqërisë nuk do t'i marrin këto pajisje duke pasur kështu më pak akses në informacion se sa përpara dixhitalizimit. Pajisja ekzistuese mund të jetë marrësi DIGITALB,

por duke qenë se pjesa më e varfër e shoqërisë mund të mos e ketë këtë, lë ende hapur pyetjen për pajisjet shtesë. Çështja e ndëroperimit është shumë e rëndësishme.

Ishujt dixhitalë dhe afatet

Strategjia përmend se dixhitalizimi do të futet sipas parimit qark për qark, duke krijuar ishuj dixhitalë. Këta do të krijohen duke marrë parasysh frekuencat e lira si dhe kushtet socio-ekonomike të zonave të ndryshme.

Afati kohor në strategji është në përputhje me rregullat e UNT-së dhe me afatin e BE-së. Mund të jetë i realizueshëm, por tashmë puna duhet të vijojë me hapa të shpejtë. Nuk është nevoja që Shqipëria ta nxitojë procesin më shumë se sa është e nevojshme, por duhet të përpiqet që të përmbushë afatet e caktuara. Objektivi i krijimit të një kuadri ligjor të përshtatshëm është mjaft i rëndësishëm. Duhet të ketë rregull në sektor mundësisht përpara kalimit. Sa i përket objektivit për të ofruar një larmi programesh, është me rëndësi që të kihen ide konkrete si duhet bërë kjo pasi zgjedhja ose shumëllojshmëria nuk vijnë automatikisht dhe jo vetëm nga numri i kanaleve. Rregullimi i aksesit dhe aplikimi i standardeve kërkon shumë punë nga ana e rregullatorit. Duhet zhvilluar parimet e licencimit si për përmbajtjen ashtu edhe për transmetimin.

Ndërhyrja e shtetit

Mes pikave të renditura për ndërhyrjen e shtetit theksohen shumë çështje të rëndësishme. Këtu përfshihet zhvillimi i një fushate sensibilizimi. Përmendet dhe puna e rregullatorit dhe aspekti ligjor, përfshirë ndarjen e transmetimit nga përmbajtja. Ky është një aspekt kyç dhe i duhet kushtuar vëmendje në strategji. Rregullatorit i duhet dhënë më shumë orientim se si do të arrihet kjo dhe gjithashtu mbi harmonizimin me standardet e BE-së përmes ligjeve dhe rregullave të tjerë.

Rolet dhe numrat e rrjeteve dhe transmetuesve

Roli i transmetuesit publik theksohet në strategji por pa hollësi. Bashkërendimi i të gjitha palëve të interesuara që përmendet në përgjithësi në vend tjetër gjithashtu theksohet dhe kjo është një pikë shumë e rëndësishme.

Sa i përket numrit të rrjeteve, numri duhet të jetë i përshtatshëm për vendin dhe i qëndrueshëm. Dy rrjete publike dhe tri private kombëtare janë gjë e mirë, por shumë. Pohimi se numri do të bazohet në studimin e tregut është i mirë në vetvete por duket disi i vonuar

pasi tashmë ekziston një situatë reale transmetimi. Është me rëndësi që të ketë përmbajtje për të mbushur allotmentet në mënyrë që të merren parasysh si shikuesit ashtu edhe ata që mbushin valët ajrore me përmbajtje. Dixhitalizimi nuk duhet të nënkuptojë një reduktim të numrit të programeve, por numri duhet të jetë realist për vendin. Në të njëjtën kohë situata nuk duhet të jetë e ngrirë por duhet të gjejnë vend programe të reja dhe interesante. Strategjia pranon se *Në llogaritjen e kapaciteteve të platformave numerike tokësore ku do të mbështeten transmetuesit analogë ekzistues, duhet të merren në konsideratë masat për ruajtjen e zonës aktuale të licencimit. Në rastet kur një gjë e tillë nuk është e mundur teknikisht, zona në fjalë mund të zgjerohet, por në asnjë rast të zvogëlohet.*

Financimi

Duhet marrë parasysh financimi i transmetimit në mjedisin dixhital. Numri i madh i kanaleve do të thotë një copëzim të audiencës dhe më pak tërheqje për reklamuesit. Nuk ka vlerë të planifikohet për shumë transmetues në nivele të ndryshme nëse në realitet nuk ka ofrues të përmbajtjes së programeve për të mbushur transmetimet dhe nuk ka mjete për të financuar ofrimin e këtyre programeve. Strategjia është optimiste për financimin e transmetuesve privatë, shumë më tepër se në shumë vende evropiane. Tregu shqiptar është shumë i ri dhe mund të jetë në rritje, por ekziston rreziku i amullisë dhe efektet e rënies së përgjithshme ekonomike do të ndihen.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Bashkëpunimi ndërinstytucional është tejet i rëndësishëm, siç përmendet dhe në strategji. Që ky bashkëpunim të funksionojë, është me rëndësi që të ketë një udhëheqës të qartë të këtij bashkëpunimi. Kjo detyrë i ngarkohet KKRT-së që është organi logjik për këtë bashkëpunim. Është me rëndësi që KKRT-ja të ketë autoritetin dhe burimet e nevojshme për të menaxhuar bashkërendimin. Grupi Teknik i përmendur në lidhje me task forcën nuk shpjegohet. Nuk është e qartë as se kur dhe si do të mblidhet task forca. Organet përkatëse duhet të detyrohen që të dërgojnë përfaqësues. Nuk është e qartë nëse KKRT-ja do të krijojë sekretariatën apo nëse ky do të jetë më vete dhe se si do të financohet Task Forca. Strategjia përmend se KKRT-ja nuk ka pasur probleme dhe se është me rëndësi që ky organ të fuqizohet në mënyrë të pavarur nga procesi i dixhitalizimit në mënyrë që të jetë vërtet i pajisur për ta udhëhequr këtë proces ndërkohë që përmbush detyrat e tjera.

Roli i KKRT-së

Roli i KKRT-së dhe forcimi i saj janë në të vërtetë të rëndësishme, por strategjia duhet të jetë më e qartë për atë që kërkohet, duke dhënë këshilla konkrete si për dispozitat ligjore që duhen ndryshuar ashtu edhe se çfarë mjetesh të tjera nevojiten për forcimin e saj (financiare, personel etj). Në strategjinë aktuale ekziston një rrezik i dukshëm që KKRT-së i jepet një rol i rëndësishëm në procesin e dixhitalizimit kur dihet (siç përmendet) se ky organ në të vërtetë është tepër i dobët. Forcimi i tij duhet të jetë një çështje më vete nga detyra e tij e shtuar në procesin e dixhitalizimit. Përndryshe ekziston rreziku real që rregullatori të mos forcohet për shkak të mungesës së përkrahjes dhe kjo mund të sjellë një vonesë në tërë administrimin e procesit të dixhitalizimit. Çështjet në strategji ndërthuren në një mënyrë që mund të jetë e ngatërruar. Dixhitalizimi nuk është një mjet për të zgjidhur problemet e tjera në fushën e transmetimeve dhe dobësitë e rregullatorit duhen trajtuar më vete.

Nga ana stilistike, mund të thuhet se sugjerimet e ndryshme faktike në strategji si situata me transmetimet e njëkohshme nuk janë shumë të qarta por “të fshehura” në tekst. Gjuha se sa kohë do të vazhdojë transmetimi i njëkohshëm nuk është e qartë por përdor shprehjen se duhet të vazhdojë sa më pak kohë të jetë e mundur. Përmendet se kjo periudhë tranzicioni do t’i lejojë qytetarët që të sigurojnë pajisjet e nevojshme për marrjen dixhitale, por rregullat konkretë se si kjo do të ndodhë gjenden në pjesë krejt të ndryshme të strategjisë. Ka edhe shembuj të tjerë të ngjashëm.

Licencimi

Qasjet evropiane

Në Evropë janë adoptuar disa qasje të ndryshme për shpërndarjen e spektrit dixhital dhe për procesin e licencimit. Kapaciteti licencohet ose për multiplekset (operatorët e rrjetit) ose drejtpërdrejt për kanalet. Rëndësi ka se si rregullohet aksesimi te ky kapacitet dhe që të përmbushë standardet më të mira rregulluese. Ndarja e licencimit të përmbajtjes (programimi) dhe transmetimit është e rëndësishme pavarësisht nga detajet e procesit të licencimit. Është e mundur që rregullatori të përzgjedhë kanalet. Mënyra si bëhet kjo përzgjedhje është e ngjashme me procesin e licencimit analog. Në vende të tjera (si Mbretëria e Bashkuar) kapaciteti jepet për t’u menaxhuar nga multipleksi (operatori i rrjetit) që përzgjedh kanalet sipas rregullave të caktuar si mbartja e detyruar ose kapaciteti i rezervuar

me ligj ose rregullore për kategori të posaçme transmetuesish. Rregullat në një farë forme janë të nevojshëm për të ruajtur objektivat e interesit publik si larmia dhe pluralizmi.⁵

Veçoritë e licencimit dixhital

Licencimi dixhital i transmetuesve në një farë mënyre ngjan me licencimin e telekomunikimit, por disa karakteristika të caktuara të transmetimit mbeten, si interesi publik në përmbajtjen e shërbimit të ofruar. Ideja e një procedure të ngjashme me një konkurs bukurie vazhdon të aplikohet shpesh. Në çdo rast, e drejta për transmetimin e televizionit dixhital tokësor jepet nën kushte të caktuara. Një prej kushteve është që duhet mbartur transmetuesi publik.⁶

Sa i përket licencimit për transmetimet ka shumë kritere që ngjajnë me licencimin e telekomunikimit, tarifat e vendosur për aksesin në mjetet e transmetimit duhet të jenë të arsyeshme dhe të monitorohen nga rregullatori. Kritere të tjera që mund të aplikohen përfshijnë sa shpejt mund të arrihet një nivel i lartë mbulimi i popullsisë, cilësia e sinjalit, shërbime të lehta për konsumatorin (përfshirë ndoshta një strategji për nxitjen e shpërndarjes së marrësve) dhe kritere të tjera të ngjashme me licencimin e telekomunikimit si dhe aftësia për të ofruar një gamë të gjerë kanalesh dixhitale që nxisin larminë e mendimit. Kufizime të veçanta mund të aplikohen për ofruesit mbizotërues të shërbimeve.⁷

Fikja e analogut dhe mbulimi dixhital tokësor

Shumica e vendeve e fikin transmetimin analog me faza rajonale. Televizioni dixhital ofrohet në formën falas ose me kanale me pagesë. Rregullatori e bën pjesë të kushteve të licencimit për të siguruar që mbulimi nga televizioni dixhital tokësor pas kalimit të arrihet në një shkallë të barasvlershme me atë të mbulimit të mëparshëm nga televizioni analog. Zotëruesit e licencave për multipleks që mbartin kanale të televizionit publik duhet të arrijnë një mbulim

⁵ Një studim i ardhshëm (pranverë 2009) i udhëzuar nga Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Medias mbi parimet e dixhitalizimit do të trajtojë më me hollësi çështjet e përgjithshme, duke sjellë shembuj nga shumë shtete. Autorët e studimit janë Dr. Andrei Richter dhe autori i analizës, Prof. Katrin Nyman-Metcalf. Autori i analizës i është mirënjohës Dr. Richter-it për disa informacione të përgjithshme të përfshira në analizë.

⁶ Grupi i Punës për Televizionin Dixhital Tokësor në Vendet EPRA. Raporti Përfundimtar, 2 qershor 2004. Shih faqen zyrtare të EPRA-s, Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregulluese: http://www.epra.org/content/english/press/papers/DTTWG_finalreport.doc

⁷ Rittler R. Austri: Ftesë për Tender për Platformë Multipleksi // IRIS 2005-7:8/11. Shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2005/7/article11.en.html>

të përcaktuar dhe të lartë të popullsisë. Për ta arritur këtë, atyre do t'u kërkohet që të transmetojnë nga pika të përcaktuara, normalisht duke përfshirë pikat e përdorura për transmetime analoge si dhe pika shitesë. Lista të pikave nga duhen bërë transmetimet duhen përfshirë në kushte. Raporte se si arrihet ecuria është një kriter tjetër i zakonshëm i licencës.⁸

E ardhmja e licencave ekzistuese

Një çështje ku siguria ligjore është thelbësore është se çfarë do të ndodhë me licencat ekzistuese të transmetimit. Është e kushtueshme që analogu dhe dixhitali të mbahen njëkohësisht, kështu që kjo nuk duhet të shërbejë si zgjidhje për asnjë periudhë kohore. Nëse ka licenca ekzistuese për transmetimet analoge, këto mund të duhet të mbyllen përpara periudhës së skadimit. Kjo është një ndërhyrje serioze me mundësinë e subjekteve private për të bërë biznes dhe duhet bërë vetëm nëse është e domosdoshme. Në këtë rast duhet përgatitur dhe zbatuar me sa më pak vështirësi. Një planifikim me një kohë më të gjatë për dixhitalizim, ku çdo licencë analoge që do të jepet do të ketë një vlefshmëri kohore të kufizuar është një mënyrë për të arritur një kalim të organizuar. Një moratorium për licenca të reja për një periudhë të caktuar si dhe preferenca për transmetuesit ekzistues të licencuar për të marrë licencën e parë dixhitale janë disa metoda të tjera. Strategjia pranon vështirësinë për të mbështetur të gjithë transmetuesit analogë në platforma dixhitale brenda vitit 2012.

Një moratorium për dhënien e licencave të transmetimit mund të jetë një hap i nevojshëm në kalimin në transmetime dixhitale. Ai i lejon autoriteteve rregullatore që të planifikojnë dhe ta përdorin me efikasitet spektrin, ndërkohë që bëjnë gjithçka gati për të filluar me licencimin e transmetuesve dixhitalë. Gjithashtu, i nxit transmetuesit që të ndërmarrin hapa praktikë për ta ndryshuar sinjalin e tyre nga analog në dixhital. Megjithatë, ekziston rreziku se moratoriumi mund të çojë në ruajtjen e gjendjes ekzistuese dhe kjo mund të mos jetë situata më e mirë e mundshme nga këndvështrimi i larmisë dhe pluralizmit.

Është diçka e zakonshme që transmetuesit ekzistues analogë të lihen që të jenë të parët që marrin licenca për transmetime dixhitale. Kjo ndihmon kalimin nga analog në dixhital dhe është zgjidhje e mirë nëse peizazhi i transmetimit në vend është pak a shumë i mirë. Nga ana tjetër, në qoftë se ky peizazh nuk paraqitet i mirë, mund të çimentohet një situatë e

⁸ Prosser T. Kushtet e Licencimit për të Arritur një Mbulim Thuajse Universal me Televizionin Dixhital Tokësor pas Kalimit // IRIS 2007-2:13/22, shih: <http://merlin.obs.coe.int/iris/2007/2/article22.en.html>

padëshirueshme, sepse derisa dixhitalizimi të kontribuojë pozitivisht në krijimin e pluralizmit duhet një kohë e caktuar.

Rregullimi i frekuencave

Sa i përket rregullimit të frekuencave, bashkëpunimi i ngushtë midis organeve të ndryshme rregullatore është thelbësor. Në një mjedis komunikimesh dixhitale, një rregullator konvergues komunikimesh mund të ketë shumë avantazhe. Megjithatë, është në dorën e vetë vendeve që të përcaktojnë se si ta projektojnë organin rregullator dhe nuk ekzistojnë kërkesa të veçanta mbi llojin e rregullatorit që duhet të krijohet. Gjithsesi, nevojitet një bashkëpunim i kujdesshëm me rregulluesin e frekuencave. Sa i përket çështjes së frekuencave të veçanta, për këtë nuk janë bërë komente në këtë analizë përveçse thuhet se duhet të ndiqet planifikimi i UNT-së dhe se ai duhet të koordinohet me shtetet fqinje. Allotment-i i sugjeruar duket i përshtatshëm, por raporti nuk hyn shumë në detaje. Ajo që është e rëndësishme është se çështja kryesore është mbulimi me sinjal i popullsisë dhe jo mbulimi i territorit. E rëndësishme është, gjithashtu, që të merret parasysh edhe gjeografia e vendit. Këtu hyjnë çështjet ndërkuftare, ku mund të kërkohen zgjidhje në bashkëpunim me shtetet fqinje. Në punën planifikuese duhet adresuar edhe situata e veçantë me frekuencat analoge që janë marrë për transmetime dixhitale pa autorizimin e duhur.

Çështjet teknike dhe të infrastrukturës

Mundësia për facilitete teknike

Në transmetimet dixhitale, mundësia për pajisje teknike transmetimi mund të përbëjë një vështirësi. Facilitetet teknike janë komplekse dhe të shtrenjta dhe nuk është si në sistemin analog, ku shumë transmetues kanë pajisjet e tyre të transmetimit. Përkundrazi, transmetimi dhe ofrimi i përmbajtjes do të jenë të ndara si nga ana ligjore, ashtu edhe nga ajo e licencimit. Kjo ndarje përbën një parim të rëndësishëm. Sipas terminologjisë së ligjit të konkurrencës, teknologjia e transmetimit është një aspekt thelbësor, pa të cilin konkurrenca është e pamundur dhe rregullatori duhet të garantojë mundësitë për akses në këtë lloj teknologjie.

Kalimi gradual është gjë e mirë për transmetuesit, pasi u jep atyre më shumë kohë për t'u përgatitur dhe lehtëson çështjen e rëndësishme të sigurisë ligjore (të marrjes së licencave atyre që kanë licenca analoge). Kjo, në të njëjtën kohë, është edhe e kushtueshme.

Strategjia shtron mënyra të ndryshme kalimi nga analog në dixhital dhe jep shumë detaje mbi mbulimin dhe transmetimin. Metoda më e mirë që sugjerohet nuk është shumë e qartë dhe megjithëse është mirë që kjo metodë të diskutohet me të gjithë aktorët e përfshirë në të, koha është e shkurtër. Do të preferohej një shpjegim më i qartë i të gjithë argumenteve pro dhe kundër zgjidhjeve të ndryshme në kontekstin shqiptar. Planifikimi për pjesët e ndryshme të vendit duhet të bëhet në mënyrë të njëpasnjëshme, gjë që nuk është e qartë, pasi koha që i jepet këtij procesi në një vend shtohet deri në 61 muaj, që është një kohë më e gjatë se koha e parashikuar për zbatimin e plotë të planit.

Dekoderat dhe barra financiare

Strategjia ofron detaje mbi kostot e dekodeve të subvencionuar. Aty jepet edhe kostoja e rrjeteve. Ky detaj është pozitiv, pasi ai përcakton bazën për punën e mëtejshme, por se kush do t'i mbulojë këto kosto nuk është edhe aq e qartë. Kjo është një çështje kyçe. Transmetuesit pritët që të mbulojnë një pjesë të kostove dhe në Shqipëri ekziston tashmë një transmetues, i cili transmeton në dixhital. E paqartë në këtë strategji është veçanërisht se si do të financojnë dhe se si do të financohen rrjetet private. Transmetuesve privatë do t'u duhet që të investojnë për dixhitalizimin. Nëse do t'u duhet edhe që të subvencionojnë dekodeve, ky është një shpenzim më tepër. Duhet kujtuar se në shumicën e vendeve interesi vullnetar për dekodera ka qenë më i vogël sesa parashikohej. Fondi për transmetuesit është ide e mirë, por vetëm nëse ai mund të financohet realisht.

Shumë shikues në një vend të varfër si Shqipëria nuk do të kenë mundësi të paguajnë një shumë shtesë për transmetimet. Ka rrezik që të ulët aksesin në informacion. Gjithashtu, ata që kanë mundësi të paguajnë mund të mos kenë dëshirë të paguajnë në qoftë se nuk e kuptojnë nevojën për ta bërë një gjë të tillë. Përkufizimi i familjeve në nevojë, mekanizmi se si do të përzgjidhen këta njerëz dhe se si do të mbështeten ata në përfitimin e marrësve është i rëndësishëm. Ky proces ka një kosto dhe ajo duhet financuar.

Vende të ndryshme kanë ide të ndryshme për mënyrat e mbështetjes së procesit të dixhitalizimit. Në shumë vende, bëhet një ulje e tarifave të licencave operuese që paguhet nga televizioni komercial për të nxitur futjen e televizionit dixhital (si për shembull në Austri, Estoni dhe Finlandë). Ka pasur edhe rritje të tarifave të abonimit që paguhet nga njerëzit, por kjo mund të mos jetë e përshtatshme për disa arsye të tjera, sidomos në vende ku mungon tradita e të paguarit të tarifave të tilla ose ku ka probleme për ruajtjen e kësaj tradite.

Për më tepër, tarifat e abonimit të transmetuesit publik konsiderohen zakonisht tarifa për përmbajtje programesh dhe jo për facilitete teknike.

Justifikimi për marrjen e një tarife abonimi për transmetuesin publik, e cila zakonisht është e detyrueshme, është se duhet të vihen në dispozicion programe me interes për publikun, si lajme cilësore, programe për minoritetet e të tjera si këto. Shumica e vendeve evropiane mendojnë se nuk është transmetuesi publik ai që duhet mbështetur, por produkti që ai nxjerr. Në qoftë se transmetuesit publik i jepet një rol në procesin e dixhitalizimit, siç ndodh zakonisht, financimi i tij do të shihet si çështje e veçantë.

MPEG 2 apo 4?

Në lidhje me teknologjinë e përdorur, është ngritur çështja nëse do të përdoret MPEG 2 apo 4. Së shpejti, dixhitalizimi do të jetë i hapur edhe për HDTV dhe atëherë mund të nevojiten edhe ndryshime të reja. Nëse është e mundur të ecim me hapa të mëdhenj dhe të shkojmë menjëherë tek teknologjia më moderne, kjo mund të jetë gjë e mirë për të gjithë. Megjithatë, në Shqipëri, transmetimet dixhitale tashmë kanë filluar, nuk është se nuk ekzistojnë. Sado i mirë që të jetë si parim, sugjerimi i të ecurit me hapa të mëdhenj do të funksionojë vetëm në qoftë se financohet nga këndvështrimi i përdoruesve dhe siguruesve të shërbimeve. Në qoftë se njerëzit i kanë pajisjet që u duhen për një standard, mund të mos jetë e përshtatshme që të kalohet direkt tek një standard tjetër. Një problem me futjen e MPEG 4 është se (normalisht) do të nevojiteshin marrësa të rinj. Aspekti kohor është i rëndësishëm: ata që e kanë bërë më herët kanë përdorur MPEG 2, kurse ata që janë prapa mund të konsiderojnë përdorimin e menjëhershëm të një versioni më modern. Në Shqipëri, DIGITALB transmeton në MPEG 2, kështu që presupozohet se njerëzit e kanë marrësin për këtë standard.⁹ BE-ja po promovon interoperability (shihni për shembull COM(2006)37 Commissions Communication) por as në BE nuk ka rregulla të përbashkëta.

Direktiva 95/47/EC merret me aspektin esencial të faciliteteve dhe aspektin e vështirësive të një sistemi me akses të kushtëzuar. Ajo përcakton disa standarde të përbashkëta për të krijuar mundësi për konkurrencë. BE-ja vlerëson se në qoftë se ata që ndërtojnë infrastrukturën do të kenë mundësi të marrin disa të ardhura për investimet e tyre, kjo mund të çojë në një lloj monopoli për një periudhë të kufizuar kohe. Ka disa rregulla ligji i BE-së për shërbimet me

⁹ Marrësat janë vetëm për programet DIGITALB, por strategjia thotë se ata mund të zhblllokohen.

interesa ekonomikë të përgjithshëm (nenet 16 dhe 86 të traktatit të KE-së) që merren me mënyrat se si këto shërbime mund të ofrohen në një mjedis konkurrent, duke marrë parasysh natyrën e veçantë të këtyre shërbimeve.

Konkurrenca midis rrjeteve të ndryshme që ofrojnë shërbime të ndryshme dhe konvergjenca më e madhe e teknologjive është një tjetër veçori e zhvillimeve të mundshme në të ardhmen.

Strategjia hedh idenë e një pronari të faciliteteve të transmetimit. Kjo mund të ketë përfitime, por do të thotë edhe monopol i krijuar nga shteti. Kjo duhet monitoruar me shumë kujdes nga rregullatori sipas parimeve të shërbimeve me interesa ekonomikë të përgjithshëm sipas ligjit të konkurrencës. Kjo gjë e vë theksin tek rregullatori dhe kërkon rregulla të detyrueshme për këtë çështje, kërkohen udhëzime, trajnime, personel i specializuar, etj, për të minimizuar pasojat negative të një monopolizimi të tillë.

Përmbajtja e programeve

Shumë rregulla transmetimi mund të mbeten të njëjta në peizazhin dixhital ashtu si janë në atë analog. Për sa i përket standardeve të transmetimit të përmbajtjes, nuk ekziston ndonjë nevojë *per se* për t'i ndryshuar këto standarde. Duke pasur parasysh gamën e gjerë të programeve, monitorimi dhe zbatimi i standardeve do të jetë sfidues. Është e rëndësishme që transmetuesit të jenë të ndërgjegjshëm për standardet dhe nivelin e zbatimit të tyre. Nëse nuk është kështu, procesi ka për të qenë shumë i vështirë. Nga strategjia duket sikur situata deri tani nuk është e kënaqshme, por se tani këtyre çështjeve do t'i kushtohet vëmendja që nuk u është kushtuar deri tani.

Roli i rregullatorit në krijimin e paketave të programeve është i rëndësishëm. Megjithatë, ekziston nevoja për të pasur prodhues programesh dhe nëse transmetuesi publik tani është i dobët, ka për të qenë e vështirë të gjendet përmbajtja e përshtatshme për arritjen e një kombinimi ideal. Strategjia e njeh këtë problem.

Pohimi rreth marrjes së programeve nga ana e audiencës pa një barrë financiare shtesë ngre çështjen e mbështetjes për pajisjet marrëse dixhitale. Edhe nëse programet janë falas, nevojitet prapëseprapë pajisja marrëse. Duke pasur parasysh numrin e madh të aparateve të televizorëve në Shqipëri, siç përmendet në strategji, pajisjet marrëse kanë për të pasur kosto

shumë të mëdha ose shumë njerëz nuk do të kenë mundësi të përdorin televizorët me të cilët janë mësuar.

Ajo që mungon në masë të madhe në këtë plan është shtjellimi i rrjeteve dhe platformave të transmetimit dhe çështjes së aksesit. Kjo përmendet si një çështje e rëndësishme, por meqenëse ajo është një parakusht për një transmetim dixhital të mundshëm dhe të qëndrueshëm, ka nevojë për vëmendje, në mos në këtë strategji, duhet të jetë një çështje kyçe në punën planifikuese. Idetë e hedhura nuk janë të këqija, por nevojitet një punë e kujdesshme rregulluese për t'u siguruar se ata që mund ta përballojnë financiarisht punën, janë ata që ofrojnë programe pluraliste. Qëllimet e ndryshme të pluralizmit dhe larmisë, duke shmangur monopolizimin, nuk pasqyrohen tek idetë e financimit. Financimi publik, partneritetet midis sektorit publik dhe atij privat, etj, mund të shqyrtohen, por sidoqoftë rregullatori duhet të luajë një rol qendror.

Plani, në shumë vende, flet për transmetimin e vazhduar analog. Në disa vende mund të ketë formulime të paqarta, që kanë të bëjnë me vazhdimin e përmbajtjes së programeve dhe jo të transmetimit analog, përndryshe çështja e kalimit nga analog në dixhital ngatërrohet.

Transmetuesi publik

Strategjia pohon se transmetuesi publik nuk ka atë mbulim që duhet të ketë sipas ligjit (nga 90% deri 99% të popullsisë, ky shërbim mbulon në fakt vetëm 73%). I njëjti koment mund të bëhet si për transmetuesin publik, ashtu edhe për çdo çështje tjetër – kalimi në dixhitalizim nuk do të zgjidhë problemet strukturore në tregun e medias. Programet dhe mbulimi i transmetuesit publik, të cilat duhet të sigurojnë vlerën e shtuar që transmetuesit komercialë nuk mund ta japin, duhet të bëhen gjithsesi e të mos varen nga dixhitalizimi. Në qoftë se transmetuesi publik i ka probleme që tani, ai ka për të pasur edhe më shumë probleme për të gjetur rolin e tij në një mjedis dixhital, ku shikuesit kanë më shumë zgjedhje.

Shërbimi publik i transmetimit nuk duhet të ketë nevojë të konkurrojë në mjedisin komercial. Ai, është e mira, të shohë për mënyra alternative financimi. Është e vështirë që të sigurohet një fushë e barabartë loje, ku shërbimi publik i transmetimit konkurron për TV me pagesë. Roli dhe detyrat e tij duhet të përcaktohen qartë në ligj.

Strategjia thotë se shërbimi publik i transmetimit nuk i plotëson kërkesat ligjit për transmetim, as për sa i përket numrit të kanaleve, as territorit/popullsisë që ai duhet të mbulojë. Këto kërkesa tani sikur lihen mënjane më futjen e dixhitalizimit, por nuk ka gjasa që televizioni

analog tokësor t'i përmbushë kërkesat e përcaktuara. Shërbimi publik i transmetimit është në një situatë mjaft të vështirë, me pajisje të vjetruara, me probleme me furnizimin me energji elektrike, si dhe me probleme të tjera, që do të thotë se shërbimi publik i transmetimit aktualisht nuk kapet në shumë pjesë të vendit. Edhe financimi i këtij shërbimi është një problem më vete, pasi tarifa (taksa) e abonimit që duhet mbledhur nuk është përcaktuar siç duhet.

KKRT-ja thekson në strategji se ajo ka kohë që ka sugjeruar të shihet mundësia e ndërtimit të një rrjeti dixhital në vend që të ndërtohet një rrjet analogu për programin e dytë të shërbimit publik të transmetimit. Rrjeti dixhital do të mbështeste programin e parë dhe të dytë, duke krijuar në të njëjtën kohë, mundësinë për transmetimin e programeve të ndryshme tematike. Shërbimi publik i transmetimit do të administronte një platformë dixhitale, në të cilën mund të vendoseshin edhe transmetues privatë. Sipas strategjisë, shërbimi publik i transmetimit duhet t'i ketë parashikuar tashmë kostot për këtë rrjet në buxhetin e tij dhe kështu duhet të jetë i përgatitur për dixhitalizimin. Në të njëjtën kohë, nga strategjia duket sikur mjetet dhe metodat e financimit nuk janë të qarta dhe se janë diçka që duhet shqyrtuar dhe vendosur.

Shërbimi publik i transmetimit duhet të ketë burimet për dixhitalizim dhe është vendi që ai të marrë rolin drejtues, nëse ai është i aftë ta luajë një rol të tillë. Nëse me shërbimin publik të transmetimit ka probleme, për shembull në lidhje me burimet që ai ka apo me mënyra e financimit të tij, këto çështje duhet të zgjidhen pavarësisht dixhitalizimit dhe këtij organi nuk i duhen dhënë detyra madhore, që ai nuk është në gjendje t'i kryejë. Kapaciteti real i shërbimit publik të transmetimit, si për të ruajtur pozitën e tij dhe për të marrë një rol të rëndësishëm në procesin e dixhitalizimit, mbetet pak i paqartë në strategji.

Përmenden detyrimet *must-carry*. Nuk është shumë e qartë (ndoshta pjesërisht edhe për shkak të përkthimit), por duket sikur këto detyrime janë pak të dobëta. Kjo është e rëndësishme nëse roli i shërbimit publik të transmetimit mendohet të ruhet apo të forcohet.

Komente mbyllëse

Strategjia përmban shumë pika të mira, si për shembull theksi që vihet tek mbulimi i popullsisë, procesi i konsultimit dhe referenca që u bëhet standardeve ndërkombëtare dhe atyre evropiane, por është më tepër një dokument fillestar sesa një strategji përfundimtare.

Dixhitalizimi i transmetimit përfshin një sërë çështjesh praktike, teknike dhe ligjore që duhen marrë parasysh në çdo plan dixhitalizimi. Në Shqipëri, ekziston realisht transmetimi dixhital në një shkallë domethënëse edhe pa mbështetjen me ligj apo me ndonjë plan dixhitalizimi.

Si pjesë e përmbledhjes dhe përfundimeve, mund të bëhen këto komente në lidhje me strategjinë:

- Dixhitalizimi nuk zgjidh probleme të tjera në fushën e transmetimit si mungesa e pluralizmit, larmisë, një shërbimi të dobët publik të transmetimit, apo një rregullatori të dobët. Këto probleme duhen zgjidhur mënyrë dhe mundësisht para procesit të dixhitalizimit, ose të paktën gjatë fazës së hershme të planifikimit të këtij procesi.
- Baza ligjore e dixhitalizimit është shumë e rëndësishme. Ajo duhet të jetë shumë e qartë dhe duhet të rregullojë situatën ekzistuese, si edhe të përcaktojë procedurat e dixhitalizimit. Ndarja e ofrimit të përmbajtjes nga transmetimi teknik është thelbësore. Ky aspekt preket shkurtimisht në strategji dhe përmendet si një nga mungesat e projektligjit. Si rrjedhojë, ky aspekt ka nevojë për vëmendje.
- Baza ligjore duhet të rregullojë situatën ekzistuese, edhe nëse në fillim nuk është ideale. Në rastin e Shqipërisë, kjo do të thotë një strategji e qartë mbi trajtimin e DIGITALB-it, duke marrë parasysh kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit dhe çështje të tjera që lidhen me faktin se transmetimi dixhital jozyrtar tashmë është një realitet. Në qoftë se këtij realiteti thjesht do t'i jepej fund, kjo do të sillte pasoja negative për konsumatorët dhe për pluralizmin.
- Strategjia duhet të zhvillohet përmes një procesi konsultimi. Dokumenti duhet t'i dërgohet për konsultim dhe t'u vihet në dispozicion partnerëve për komente. Është e rëndësishme që të merren parasysh, si dhe të shihet se po merren parasysh edhe pikëpamjet e partnerëve. Konsultimi nuk mund të përfundojë me miratimin e strategjisë, por ai duhet të vazhdojë, sidomos për shkak se kjo strategji nuk është edhe aq e qartë në të gjitha çështjet.
- Duhet të ketë një fushatë të informimit publik për të rritur ndërgjegjësimin dhe për t'i bërë njerëzit që ta shohin pozitivisht procesin e dixhitalizimit. Kjo është e rëndësishme nëse ata duhet të jenë të interesuar për të marrë pajisjet e posaçme marrëse. Një fushatë e tillë përmendet në strategji, por jo në mënyrë të hollësishme.

- Për interpretimin e koncepteve dhe nocioneve në strategji duhen përdorur standardet ndërkombëtare (standardet evropiane ose të tjera), të cilave u referohet strategjia. Kjo mund të lehtësohet nga një listë terminologjie e përdorur si pjesë e strategjisë, ose si një dokument i veçantë i lëshuar nga rregullatori.
- Financimi i procesit është thelbësor dhe duhet të sqarohet në mënyrë transparente dhe të plotë në një fazë të hershme.
- Bashkëpunimi ndër-institucional është i rëndësishëm dhe ka nevojë për një kuadër të qartë. Këtu përfshihet financimi, sekretariati i emëruar dhe një detyrim i qartë për të gjithë institucionet e interesuara lidhur me emërimin e përfaqësuesve që do të kenë mandatin e duhur për ta diskutuar këtë çështje. KKRT-ja duhet të forcohet në mënyrë që të jetë në gjendje t'i kryejë këto detyra.
- Aksesit në facilitetet e transmetimit është thelbësor dhe një kusht i rëndësishëm licencimi, ku rregullatorit i duhet një mandat i qartë. Nëse krijohet/lejohej një ofrues transmetimesh i monopolizuar, rregullatori duhet ta monitorojë me kujdes atë dhe të garantojë sa më shumë akses dhe zbatimin maksimal të parimeve të ligjit të konkurrencës. Për të qenë e aftë për t'i kryer këto detyra, KKRT-ja duhet të forcohet.
- Detyrimet *must-carry* dhe rregullat e përgjithshme për shërbimin publik të transmetimit duhet të forcohen dhe të jenë më të dukshme në strategji. Puna paralele për forcimin e shërbimit publik të transmetimit duhet të vazhdojë.
- Duhet të sqarohen rregullat që përcaktojnë se kush ka të drejtë të përfitojë dekodera të subvencionuar, si do të jepen ata, si dhe mënyrat e identifikimit dhe të llogaritjes së kostos së këtij procesi.